



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

### PROCESVERBAL

#### **Mbajtur më 12 dhjetor 2024, në mbledhjen e gjashtë (6) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:12

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z.Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë; z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete; znj.Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z.Nazif Sheqa Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit- Podujevë; z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z.Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Ndërsa munguan: z.Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z. Shefki Selmani përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; z.Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Sevdije Mustafa përfaqësuese e komunitetit egjiptian; znj. Ilirianë Bunjaku, përfaqësuese e FSK-së; z.Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z.Bahri Selimi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim dhe z. Shemsi Jashari përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe, Përfaqësuesi i KFOR-it z. Karoly Kovacs & z.Asdren Llugaliu- përkthyes; Përfaqësuesi i FSK-së (Në vend të znj. Ilirianë Bunjaku; z. Përparim Shala dhe z. Ryan Sherba -OSBE.

**z.Bahri Selimi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi**, përshëndetje për të gjithëve, mirë se keni ardhë në mbledhje të KKS-së, së pari ju njoftoj se këtë mbledhje do e kryesoi unë me autorizim nga Kryetari i Komunës z.Shpejtëm Bulliqi pasi që Kryetari dhe Nënkryetarja e Komunës janë të angazhuar në punë dhe detyra tjera të punës dhe nuk mund të jenë prezent këtu me ne, materialet për mbledhje konsideroj se i keni marrë të gjithë me kohë, ku për sot parashihet ky rend i ditës

**1.Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 01.11.2024**

- 2.Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë**
- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë
  - Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

### 3.Miratimi i propozimit të planit të punës së KKSb-së për vitin 2025

#### 4.Të ndryshme.

**z.Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, theksoi, së pari unë para se të vazhdojmë tutje kam një pyetje Kryetari nuk është, Nënkryetarja nuk është, a keni të drejtë me udhëheq ju këtë mbledhje sipas udhëzimit për KKSb-në, mesa unë e di kur mungon Kryetari duhet Nënkryetarja me qenë këtu, nëse mungojnë të dytë nuk ka dikush tjetër mundësi sipas udhëzimit me udhëheqë këtë mbledhje. Zyrën ligjore e kem këtu dhe besoj se mund të na japë ndonjë interpretim, po flasim për një dokument shumë të rëndësishëm siç është plani i punës dhe nuk ishte dashur deri në këtë shkallë të injorohet prej Kryetarit dhe prej Nënkryetares ky takim, nëse ne jemi aq të pa rëndësishëm si këshill mos na maltretoni pasi që secili prej nesh kemi angazhime në fushat tona ku punojmë dhe nuk kemi ardhë këtu veç se s'kemi çka me bë, kemi ardhë këtu për shkak se është shumë i rëndësishëm ky këshill, prandaj kisha kërkuar interpretim prej zyrës ligjore se a ka të drejtë dikush tjetër përveç Kryetarit dhe Nënkryetares që ta udhëheq këtë mbledhje.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, unë ju tregova që në fillim se Kryetari është në angazhime të rëndësishme se sot i nënshkruan dy memorandume të rëndësishme me ministritë përkatëse për projektet e Komunës së Podujevës, Nënkryetarja nuk është në komunë do të thotë mungon dhe unë mbledhjen e udhëheqi me autorizim të Kryetarit. Tash nëse ty tu doket injorim është çështje e jotja krejt personale edhe ne nganjëherë ndjehemi të injoruar kur ti nuk merr pjesë në këtë mbledhje që po e quan kaq të rëndësishme që shpesh nuk merr pjesë.

**z.Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, theksoi, nuk është shpesh se shumicën e mbledhjeve kam qenë prezent, më shumë keni munguar ju.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, nëse ty të doket injorim kjo është mbledhje e përfaqësuesve të kategorive të shoqërive të ndryshme mundesh mos me marrë pjesë nuk është asnjë problem.

**z.Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, theksoi, nuk më keni zgjedhë ju por në këtë këshill më ka zgjedh kuvendi.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, ti je propozuar nga dikush dhe në asnjë mënyrë KKSb nuk injorohet sepse e ka një rëndësi të veçantë.

**z.Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, theksoi, ku është Kryetari dhe Nënkryetarja e Komunës drejtor.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, nuk mundem me ta përsëritë 20 herë këtë çështje, unë të thash Kryetari është në Ministri.

**z.Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, theksoi, je në kundërshtim me udhëzimin se je duke udhëheq në një mbledhje që duhet me udhëheq tjetër kush.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, unë të thash Kryetari është në ministri dhe ka me nënshkruar dy marrëveshje të rëndësishme.

**z.Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, theksoi, atëherë ai është dashur ta shtyjë këtë mbledhje.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, unë të thash se këtë mbledhje e udhëheqë me autorizim të Kryetarit dhe nëse në udhëzim administrativ thuhet se nuk ka të drejtë me udhëheq dikush tjetër mbledhjen përpos Kryetarit të komunës me autorizimin e tij jemi në rregull.

**z.Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, theksoi, zyra ligjore e ka udhëzimin.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, jo vetëm zyra ligjore por edhe ti duhet me pas udhëzimin administrativ pasi që po thirreni në të, unë po të them kur Kryetari nxjerr autorizim atëherë në bazë të atij autorizimi që zbatohet udhëhiqet kjo mbledhje.

**z.Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, theksoi, kjo është e pa drejtë nuk është dashtë në këtë formë me na injorua.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, nëse keni diçka për rendin e ditës urdhëroni.

**z.Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, theksoi, a keni të drejtë, a po s'keni të drejtë me udhëheq këtë mbledhje.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, unë sqarimin tim ta dhashë, tash le të japë sqarime zyra ligjore pasi që po kërkon sqarime prej saj.

**z.Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, theksoi, atëherë kisha pas dëshirë që dikush nga zyra ligjore të na thotë se çfarë thotë udhëzimi administrativ.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, atëherë le të urdhëron dikush nga zyra ligjore le të na shpjegon se çka përshkruhet në udhëzim administrativ.

**z.Qefser Behrami**, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimeh, theksoi, sa i përket informatave atëherë sipas këtyre informatave që i ceke në rend dite më herët si ato të KFOR-it, POLICISË, FSK-së , a kemi të drejtë edhe ne të japim informata si përfaqësues të Këshillit Lokal për Siguri Publike, prandaj kisha pas dëshirë që të përfshihet edhe një informatë nga unë si përfaqësues i KLSP-së.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, nëse ke ti ndonjë pikë të rendit të ditës ke të drejtë ta propozosh atë për atë ne e kemi hapë diskutimin rreth rendit të ditës, prandaj edhe një herë ju them nëse keni ndonjë propozim për rendin e ditës urdhëroni me propozimet e juaja.

Sa për sqarim rendi i ditës përgatitet prej zyrës së kryetarit dhe zyrës ligjore dhe është ky rend dite që e kani para jush.

**z.Qefser Behrami**, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimeh, theksoi, këto janë mendimet e juaja dhe unë nuk pajtohem me këtë.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, nëse nuk pajtoheni me këtë atëherë paraqiteni propozimin e juaj si pikë të re të rendit të ditës sepse është e drejtë e juaja.

**z.Qefser Behrami**, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimeh, theksoi, edhe unë edhe kolegu im z.Nuhi Selimi kërkojmë që të paraqesim nga një informatë si

përfaqësues të KLSP-ve sepse ne jemi të zgjedhur nga përfaqësuesit e fshatrave dhe ky kuvend komunal.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, a jeni duke kërkuar që të futet si pikë e rendit të ditës informatë nga KLSP-të.

**z.Qefser Behrami**, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh, theksoi, po patjetër.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, atëherë e vë në votim që të futet si pikë e rendit të ditës informatë nga KLSP-të.

**z.Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, theksoi, atëherë kisha pas dëshirë që dikush nga zyra ligjore të na thotë se çfarë thotë udhëzimi administrativ se a keni ose jo ju të drejtë ta udhëhiqni këtë mbledhje, duhet ta dimë ne a ka legjitimitet kjo mbledhje se po merren vendime këtu.

**z.Osman Bajrami**, zyrtar-zyra ligjore, ndër të tjera theksoi, sa për sqarim së pari ne nuk jemi anëtarë të këtij këshilli dhe nuk kemi të drejtë të japim opinione ose mendime aty për aty.

**z.Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, theksoi, a ka mundësi së paku sa për informim të na thoni se çfarë thuhet në udhëzim administrativ.

**z.Osman Bajrami**, zyrtar-zyra ligjore, ndër të tjera theksoi, edhe njëherë sa për sqarim ne nuk jemi anëtarë të këtij këshilli dhe nuk kemi të drejtë të japim opinione ose mendime aty për aty mirëpo me pëlqimin e juaj mund t'ju them se një gjë e tillë është rregulluar në udhëzim administrativ nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL Për Këshillat Komunale Për Siguri në Bashkësi në nenin 8 thuhet;

#### *Neni 8*

##### *Kryesuesi i KKSBB-së*

*1. Ashtu siç përcaktohet në paragrafin 3 të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/076 për Policinë, Kryesuesi i KKSBB-së duhet të jetë Kryetari i Komunës përkatëse.*

*2. Në rast të mungesës së Kryesuesit në ndonjë takim, takimin e kryeson zv. Kryetari i Komunës, me të drejta dhe përgjegjësi të plota ashtu siç i ka Kryesuesi i KKSBB-së.*

Mirëpo edhe në Ligjin nr.03/L040 Për Vetëqeverisjen Lokale parashihet që Kryetarin e Komunën në rast mungese e zëvendëson Nënkryetari i Komunës, po ashtu në bazë të këtij ligji ekzekutivi i komunës emërohet nga kryetari i cili mund ata t'i autorizojë të kryejnë punë dhe detyra të punës, për rastin në fjalë ju lutem na u adresoni me shkresë zyrtare dhe ne si zyrë do ju japim përgjigje ashtu siç parashihet në rregullativen ligjore në fuqi.

**z.Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, theksoi, unë e di që këto mbledhje janë bë shumë formale beso vetëm vijnë e shkojnë këtë e them se asnjë pikë e planit të punës nuk është realizuar asnjëherë hiç. Vjen komandanti i Stacionit të Policisë, KFOR, FSK, raportojnë në suaza të rregullta dhe krejt puna e KKSBB-së, fokusohet në këtë. Është plani i punës i vitit të kaluar dhe asnjë pikë nuk është implementuar, tash se u bë formale e di por të paktën mos na nënçmoni se kjo nuk është aq e thjeshtë edhe nuk është as kryetari e as nënkryetarja por a është dikush në komunë këtë e them pa të keqe se s'kam asgjë personale me ty dhe e them se është e kundërta se personalisht të vlerësoj shumë më shumë se ata dy tjerët por kjo është çështje ligjore dhe e integritetit tonë.

Ta zëmë se mua nuk më bëni hesap por kemi këtu përfaqësues të rëndësishëm e ai nuk mund të thotë se s'kam kohë se është caktuar agjenda dhe nuk nënshkruhet një marrëveshje aty për aty se është një planë bukur i gjatë për me ardhë deri te marrëveshja për ta nënshkruar kryetari dhe ai le të nënshkruan ç'a të mundet por le ta shtyn mbledhjen për një datë të caktuar se të gjithë ne kemi lënë punë tjera për ta respektuar pozicionin që kemi marrë, tash ne e dimë që është fushatë por të paktën kursehuni një orë prej fushate.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, unë e sqarova këtë çështje dhe nuk kam ç'a të them më për këtë dhe pa humbur kohë e vë në votim rendin e ditës sipas thirrjes dhe materialit që keni marrë.

## **Rendi i Ditës**

**1.Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 01.11.2024**

**2.Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë**

- **Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë**
- **Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë**

**3.Miratimi i propozimit të planit të punës së KKS-së për vitin 2025**

**4.Të ndryshme.**

**z.Shemsi Jashari**, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, theksoi, para se të votojmë kërkoj vetëm që të evidentohet në procesverbal që unë e lëshoj mbledhjen për shkak se nuk ka legjitimitet kryesimi i kësaj mbledhje.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim theksoi, të nderuar pjesëmarrës na vjen keq për këtë situatë dhe ju them se numri i anëtarëve pjesëmarrës në këtë takim të këshillit ishte thuajse i kufizuar dhe tash njerëzit dalin dhe e lëshojnë mbledhjen për arsye të ndryshme e që në fakt munden me ditë që mund të bëhen pengesë për zhvillimin e një mbledhje kaq të rëndësishme si do që të jetë në mungesë të kuorumit unë detyrohem që këtë mbledhje ta ndërprejë dhe ta shtyj në një afat të pa caktuar deri në njoftimin e radhës, sigurisht se ju për takimin e radhës do njoftoheni përmes emailit për datën dhe kohën e vazhdimit të kësaj mbledhje.

**Vazhdimi i mbledhjes së gjashtë të datës 12 dhjetor 2024, të Këshillit Komunal Për Siguri në Bashkësi**

Mbledhja u mbajt më datë 24.12.2024, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:15

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës;

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: znj.Marigona Lahu Nënkryetare e Komunës; z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z.Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë; znj.Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z.Nazif Sheqa Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit- Podujevë; z.Nexhip Jaha,

Toger, përfaqësues i FSK-së; z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z.Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim; z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete;

Ndërsa munguan: z.Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z. Shefki Selmani përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; z.Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Sevdije Mustafa përfaqësuese e komunitetit egjiptian; z.Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z.Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Shemi Jashari përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta; z.Bahri Selimi drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it; z.Bekim Karaxhija përfaqësues i OSBE-së.

**znj.Marigona Lahu**, theksoi, po vazhdojmë me mbledhjen e datës 12.12.2024, para jush besoj që keni materialin dhe thirrjen e kësaj mbledhje, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën rreth rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim rendin e ditës sipas thirrjes dhe materialit që keni marrë.

#### **Rendi i Ditës**

**1.Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 01.11.2024**

**2.Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë**  
- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë  
- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

**3.Miratimi i propozimit të planit të punës së KKSBB-së për vitin 2025**

**4.Të ndryshme.**

*znj.Marigona Lahu, konstaton se njëzëri nga anëtarët prezent miratohet rendi i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.*

**1.Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 01.11.2024.**

*znj.Marigona Lahu, konstaton se njëzëri nga anëtarët prezent miratohet ekstraktit i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 01.11.2024.*

**2.Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë**  
- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-it për sigurinë në komunë  
- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

**z.Bashkim Bajrami**, Komandant i Stacionit të Policisë, theksoi, sa i përket situatës së sigurisë të përgjithshme, situata është e qetë stabile pa ndonjë indikacion për përkeqësim të sajë, kemi pas një numër të konsiderueshëm të rasteve të trajtuar në këtë kohë por këto nuk kanë ndikuar në përkeqësim të situatës të përgjithshme në zonë, fokusi ynë gjatë kësaj periudhe ka qenë sigurimi i një ambienti të qetë për të gjithë qytetarët parandalimi i kryerjes së veprave të ndryshme penale, arrestimi i personave që kanë kryer vepra të ndryshme dhe që kanë rënë ndesh me ligjin. Për të realizuar detyrat tona të përditshme për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike kemi planifikuar si dhe organizuar plane të ndryshme operative qoftë në parandalim të aksidenteve të trafikut apo parandalimin dhe zbulimin e veprave të ndryshme penale. Kemi bërë edhe kontrollim të shtëpive dhe objekteve përcjellëse të personave që kanë qenë të përfshirë në aktivitete kriminale po ashtu edhe në raste të ndryshme të raportuara, kemi pas një bashkëpunim të mirë për t'i arrit këto objektiva me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim dhe Drejtorinë e Arsimit ku kemi sjellë plane të ndryshme të përbashkëta për ta parandaluar veprimtaritë e ndryshme që kanë qenë në kundërshtim me ligjin. Gjatë muajit nëntor kemi mbajtur ligjëratat permanente nëpër shkolla ku janë mbajtur gjithsej 30 ligjëratat në klasat 6-9 me temat bullizimi si dhe masat parandaluese, respektimi i shumëllojshmërisë së shoqërisë me qëllim të parandalimit të ekstremizmit dhe vandalizmit të dhunshëm po ashtu janë mbajtur ligjëratat në 13 shkolla ku pjesëmarrës kanë qenë 1608 nxënës, ligjëratat janë pritur mirë si nga nxënësit dhe personeli arsimor i shkollave. Njësia e policëve në shkolla me qëllim të parandalimit të problemeve dhe krijimit të një ambienti të qetë në shkolla vazhdimisht kemi pas takime me drejtorët e shkollave si dhe me drejtorin e DKA-së. Gjatë kësaj periudhe që kemi raportuar deri në takimin e fundit janë të raportuara 138 raste të ndryshme, prej tyre 38 kanë qenë aksidente të trafikut dhe në vazhdimësi jemi duke i realizuar planet operative siç është shtimi i vigjilencës dhe masave të sigurisë në Republikën e Kosovës, pastaj plani operativ për parandalimin e grabitjeve, vjedhjeve, vjedhjeve të rënda, planin operativ të sezonit dimëror si dhe gatishmëria vepruese që ka filluar të zbatohet tash për festat e fund vitit. Më datën 18.12.2024, kemi mbajtur një takim me pronarët e bizneseve të mëdha në zonën tonë siç janë restorantet pompat e derivateve, pronarët e argjendarive dhe bizneset tjera qëllimi i këtij takimi ka qenë çështja e sigurisë së përgjithshme të këto biznese, përkatësisht sigurimi i pronës. Është diskutuar aspekti i arritjes së një ambienti më të sigurt për qytetarët e Komunës së Podujevës dhe në përgjithësi, kaq kisha për të informuar nëse dikush prej jush ka diçka për të pyetur jam këtu për t'ju përgjigjur.

**znj.Marigona Lahu**, theksoi, i dëgjuam statistikën që i dha komandanti i policisë e hapim diskutimin për këtë raport të policisë së Kosovës, nëse dikush është i interesuar për ta marrë fjalën lirish urdhëroni, nëse jo atëherë kalojmë te informata e radhës.

#### **- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-it për sigurinë në Komunë**

**Karoly Kovacs**, përfaqësues i Kforit për sigurinë në komunë, theksoi, sa i përket punës së sigurisë nuk ka ndryshuar asgjë sa i përket mandatit në ende vazhdojmë ta kryejmë detyrën sipas rezolutës së OKB-së 12/44, ne vazhdojmë ta kryejmë detyrën tonë sa i përket sigurimit të lëvizjes së lirë dhe ambientit të përbashkët në territorin e Kosovës, për të gjitha komunitetet pa marrë parasysh etninë e tyre. Gjithashtu dua të theksoj se KFOR si institucion i sigurisë është reaguesi i tretë në çdo situatë pas policisë së Kosovës dhe forcave të Eulex-it, meqenëse është mbledhja e fundit për këtë vit ua uroj vitin e ri.

## **Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për siguri në Komunë**

**Përfaqësuesi i FSK-së për siguri në Komunë**, theksoi, sa i përket nivelit të sigurisë duke u bazuar në situatën të cilën jeni të informuar ne jemi duke bërë disa patrullime te infrastruktura kritike duke kontrolluar pikat kyçe siç është liqeni i Batllavës dhe infrastrukturën e përgjithshme siç janë urat të cilat kanë një rëndësi të veçantë, mbi të gjitha zona e Podujevës në këtë rast nga ana jonë nuk parashihet ndonjë rrezik që potencialisht që mund ta prekë këtë zonë, është e menaxhueshme kjo pjesë sipas institucioneve lokale e ky fakt na gëzon edhe neve. Ne si FSK e vlerësojmë sigurinë e sidomos gjatë kësaj kohe kur është periudha dimërore dhe potencialisht ka ndonjë vërshim dhe FSK-ja ka nivelin e tretë kombëtar të reagimit por prapë po them na gëzon fakti se si komunë menaxhohet shumë mirë prej autoriteteve lokale.

### **3.Miratimi i propozim planit të punës së KKSB-së për vitin 2025**

**znj.Marigona Lahu**, theksoi, ashtu siç e keni marrë materialin për planin e punës së KKSB-së për vitin 2025, nëse dikush ka ndonjë propozim që nuk është fut në këtë plan mund ta diskutojmë tani, nëse keni ndonjë vërejtje, koment apo sugjerim urdhëroni, pasi që askush nuk po paraqitet për ndonjë vërejtje apo propozim atëherë kalojmë në miratim të këtij plani, atëherë e vë në votim këtë plan të punës.

*znj.Marigona Lahu, konstatoj se njëzëri nga anëtarët prezent miratohet plani i punës së KKSB-së për vitin 2025*

### **4.Të ndryshme.**

**znj.Marigona Lahu**, theksoi, kush do nga ju që ka ndonjë çështje lidhur me sigurinë në Komunën e Podujevës mund ta merrni fjalën.

**z.Nuhi Selimi**, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan, theksoi, sa i përket asaj që thatë më herët a ka vërejtje them se mund të mos ketë por them se ky takimi i yni ose ka kaluar në formalitet ose është i pa vlerë për shoqërinë pra janë këto dy elemente, që ka kaluar në formalitet ky takim më mirë është të na tregoni me kohë sepse vijmë në dy takime dhe kryetari nuk është prezent i cili është edhe përgjegjësi kryesor i këtij takimi se kemi pas të bisedojmë shumë gjëra.

Neve na i kanë ndalë mëditjet edhe pse po dëgjoj se dikujt i është rregulluar kjo çështje dhe ky është një diskriminim shumë i madh tash ose është një diskriminim pse jem shqiptarë ose pse s'dimë me punu njëra prej tyre duhet të jetë arsyeja, unë po i shohë se gjithkund po i marrin mëditjet pse te ne jo, kjo është e themeluar me vendim të kuvendit se ne nuk kemi ardhë prej qiellit e askush nuk ka sjellë me zor. Më datë 17.11.2024, unë kam mbajtur takimin e KLSP-Orllan atje ka kërkesa të shumta, ka vërejtje të shumta, krejt vërejtjet lidhen me Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit edhe pse shumë çështje janë përmend me vite dhe jo vetëm këtë mandatin e juaj po them atje ka hasë në vesh të shurdhër gjithçka. Tani një kërkesë është vendosja e kamerave të sigurisë prej pendës së Batllavës deri në Orllan pasi që në stacionin e policisë tashmë është vetëm një polic dhe çështja e sigurisë është për tu diskutuar nga ana jonë se janë 18 fshatra që e përbëjnë këtë KLSP, 18 fshatra e kanë një polic në Orllan që e ruan një objekt, do të thotë s'kemi ç'a të bisedojmë më a është serioze ose jo çështja e sigurisë. Kërkesë tjetër e



kamotshme është për polic të shtrirë te shkolla sepse ka vozitës të pa ndërgjegjshëm pastaj kërkesë është edhe largimi i gurit në afërsi të restorant “Adriatikut” që është qarë dhe paraqet rrezik dhe dikush duhet të mbaj përgjegjësi vetëm lutemi që mos të ndodh ndonjë fatkeqësi, mirëpo për këtë duhet dikush të japë llogari sepse kjo kërkesë është iniciuar para disa viteve edhe pse është premtuar se do ndërmerren masa mirëpo një gjë e tillë ende nuk ka ndodh. Kemi një kërkesë prej fshatit Metergofc për vendosjen e barrierave mbrojtëse në dy kthesat e rrugës së fshatit të cilat paraqesin rrezik për transportin e nxënësve sidomos gjatë stinës së dimrit, por të njëjtën kohë kërkesë dhe pyetje e banorëve të asaj ane është pse s’është policia në fshatin Orllan.


**znj.Marigona Lahu**, theksoi, sa i përket mos prezencës së kryetarit është për shkak të angazhimeve që ka mirëpo në bazë të ligjit në mungesë të kryetarit mua më lejohet udhëheqja e këtij takimi kështu që për secilin problem apo vërejtje që ke për t’ia adresuar kryetarit mund ta adresosh te unë, krejt këto që t’i i potencove evidentohen në procesverbal. Sa i përket policisë nuk më përket mua të përgjigjem sepse kjo është përgjegjësi e nivelit qendror dhe ndoshta komandanti i policisë mund të na përgjigjet mirëpo ne mund të kemi edhe takime të përditshme për kërkesat e rajonit të Orllanit dhe pa dyshim që ne i evidentojmë.

**z.Bashkim Bajrami**, Komandant i Stacionit të Policisë, theksoi, policia është në detyrë nonstop 24h, pra sipas detyrës operative mbulohet, momentalisht nuk është nënstationi me personel në stacion por nga stacioni i policisë në Podujevë mbulohet ai rajon pa vonesë.

**znj.Marigona Lahu**, theksoi, nëse dikush tjetër ka diçka për të shtuar në pikën të ndryshme urdhëroni nëse jo unë e mbyll këtë takim pasi që është edhe mbledhja e fundit e vitit 2024 unë ju uroj shëndet e të gjitha të mirat në vitin 2025, duke shpresuar se KKSBB në vitin 2025 do të vazhdoj me më shumë punë dhe angazhime.

**Mbledhja përfundoi në orën 10:55**

**Procesverbalin e mbajti**

**Osman Bajrami** 

**Nr. 02-060/04-0079032/24**

**Podujevë, 24 dhjetor 2024**



**Nënkryetaria e Komunës  
Marigona Lahu**